



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**GJYKATA ADMINISTRATIVE E SHKALLES SE PARE SHKODER**

*Adresa: L. Qemal Stafa, Rr. Don Bosko, Tel&Fax +355 22 21 21 21 21 dhe +22 21 21 21 22*

**Nr. Rregj.Them. 1071(31025-003853-83-2016)**  
**Dt. Rregj. 12.04.2016**

**Nr. Vendimi 497(415)**  
**Dt. Vendimi 29.06.2016**

**V E N D I M**  
**"NE EMER TE REPUBLIKES"**

Gjykata Administrative e Shkalles se pare Shkoder e perbere nga:

**Valbona DURRAJ – gjyqtare**

Asistuar nga sekretare seance Borana Liti, sot me datë 29.06.2016, ora 12.00 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore çështjen administrative me nr.Rregj.Them. 1071 (31025-00385-83-2016) datë 12.04.2016, që i përket palëve ndërgjyqëse:

**PADITËS:** Subjekti Fizik "PASHK KALAJA" K37810382H, me adrese Lagjia nr 1, Rruga Bulevardi Kryesor, Nd .3 kateshe kati I, Laç( në mungesë).

**TE PADITUR:** 1.Drejtoria Rajonale e Tatimeve Lezhe ( në mungesë)  
2.Drejtoria e Apelimit Tatimor Tirane ( në mungesë).

**me pjesmarrie te;** Avokatura e shtetit Tiranë( në mungesë).

**OBJEKTI:** 1.Konstatimi e pavlefshem te Njoftimit te vleresimit nr 15230/6 prot date 30.12.2015 Drejtorise Rajonale Tatimore Lezhe dhe vendimit nr 423/1 prot 2020/1 date 07.03.2016 te Drejtorise se Apelimit Tatimor Tirane.  
2.Pezullimin e zbatimit te vendimit te mesiperm deri ne perfundimin e gjykimit te ceshtjes.

**BAZA LIGJORE:** Neni 15,16,17,18 I Ligji Nr. 49/2012 "Per organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarreshjeve administrative" Ligji 9920 dt.19.5.2008 "Per Procedurat Tatimore ne RSH" I ndryshuar, neni 109 e vijues.

Gjykata ne perfundim te hetimit gjyqesor, pasi administroi provat shkresore te paraqitura, në mungesë të palëve ndërgjyqëse, mori në shqyrtim kërkesë padinë e palës paditëse i cili kërkon: Pavlefshmërinë absolute te Njoftimit te vleresimit nr 15230/6 prot date 30.12.2015 Drejtorise Rajonale Tatimore Lezhe dhe vendimit nr 423/1 prot 2020/1 date 07.03.2016 te Drejtorise se Apelimit Tatimor Tirane si dhe pezullimin e zbatimit te vendimit te

mesiperm deri ne perfundimin e gjykimit te ceshtjes, prapsimet e palës së paditur që kërkon rrezimin e kërkesë padisë si të pa mbështetur në ligjë dhe në prova, shqyrtoi dhe analizoi çeshtjen ne teresi:

### **VEREN se:**

Paditesi Subjekti Fizik "Pashk Kalaja" i eshte drejtuar Gjykates Administrative Shkalle e Pare Shkoder me kerkese padi kunder anes se paditur Drejtoria Rajonale e Tatimeve Lezhe dhe Drejtoria e Pergjithshme e Tatimeve Tirane, me objekt; Konstatimin e pavlefshem te Njoftimit te vleresimit nr.15230/6 prot. date 30.12.2015 Drejtorise Rajonale Tatimore Lezhe dhe vendimit nr 423/1 prot. 2020/1 date 07.03.2016 te Drejtorise se Apelimit Tatimor Tirane si dhe pezullimin e zbatimit te vendimit te mesiperm deri ne perfundimin e gjykimit te ceshtjes.

### ***Rrethanat e ceshtjes:***

Nga ana e DRT-Lezhe me urdherin e punes nr 562 dt 28.09.2015 eshte ushtruar kontroll ne subjektin fizik "Pashke Kalaja" dhe, eshte mbajtur Akt-Konstatimi me nr serial 0540154 dt. 30.09.2015, ku ne permbajtje të tij thuhej: ne momentin ne pune u gjend Z,Pashke Kalaja dhe Kreshnik Kalaja me nr ID H6051108 UK, pas verifikimeve ka rezultuar qe punonjesi Kreshnik Prenga ishte i pa deklaruar ne organin tatimore .

Nga ana e paditur eshte mbajtuar Njoftim Vleresim nr 15230/6 prot. date 30.12.2015 per detyrimet si me poshte :

*1-Vleresim Tatimor 50.000 leke per mosdeklarim te punesuarve ne organin tatimor.*

Kete vendim e ka ankimuar ne DRTP –Tirane dhe drejtoria e Apelimit Tatimor Tirane ne vendimin e saj ka refuzuar ankimin administrative te bere nga ana jone duke vendosur :

Lenien ne fuqi te aktit administrative,objekt ankimi,Njoftim Vleresimi per Detyrimet Tatimore nr. 15230/6 prot date 30.12.2015 te leshuar nga Drejtoria Rajonale Lezhe,detyrimin per gjobe ne shumen 50.000 leke per punemarres te padeklaruar dhe rrezimin e ankimit.

### ***Ne kërkesë padi paditësi parashtrohet se :***

Duke ju referuar Akt-Konstatimit te mbajtur ne ambientet ku pretendohet se gjate kontrollit eshte gjetur nje punonjes i padeklaruar si i punesuar e kundershtojme atë pasi nuk eshte i bazuar ne ligj . Nga ana ime si Subjekt, punonjesit tatimore jane sqaruar se Kreshnik Prenga eshte punonjesi i Eurollotos, i Subjektit Tatimor "TOP START" te cilen ne e disponojme ne Lokal dhe rezulton i siguruar qe prej vitit 2009 .

Nga ana jone jane sqaruar punonjesit e Administrates Tatimore Lezhe se punonjesi eshte i siguruar.

Nga ana ime si Subjekt Fizik Tatimor kam bere deklarimin ne sistemin tatimor te punonjesit Kreshnik Kalaja pasi e kam punesuar edhe si punonjes me kohe te pjeshme si kamarier.

Ne zbatim te ligjit nr 9920 date 19.05.2008"Per Procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperise " nga ana ime si Subjekt e kam deklaruar punonjesin brenda dites qe ka filluar pune me date 30.09.2015.

Me vendimin nr 423/1 prot 2020/1 date 07.03.2016 te Drejtorise se Apelimit Tatimor Tirane te Drejtorise se Apelimit Tatimor prane Drejtorise se Pergjithshme te tatimeve Tirane jemi njohur ne si Operator Ekonomik ardhur me Poste.

Drejtoria e Apelimit Tatimor Tirane ne vendimin e saj ka refuzuar ankimin administrative te bere nga ana jone duke vendosur :Lenien ne fuqi te aktit administrative ,objekt ankimi ,Njoftim Vleresimi per Detyrimet Tatimore nr. 15230/6 prot date 30.12.2015 te leshuar nga

Drejtoria Rajonale Lezhe, detyrimin per gjobe ne Shumen 50.000 leke per punemarres te padeklaruar dhe rrezimin e ankimit.

Kunder ketij vendimi ,bazuar ne ligjin nr 9920 date 19.05.2008"Per Procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperise (I ndryshuar), lejohet ankimi ne gjykatën administrative ,Brenda 30 diteve kalendarike nga data e marrjes dijeni.

**Ana e paditur ne parashtrimet para gjykates** ka pretenduar se;

Nje akt administrative absolutisht i pavlefshem. do te quhet ne rastet kur:

- a) kur akti administrativ eshte njerre nga nje organ i administrativ i paidentifikuar.
- b) kur akti administrativ eshte nxjerre nga nje organ administrativ ne kapercim te kompetencave te tij ligjore.
- c) Kur akti administrativ eshte nxjerre ne kundershtrim me formen dhe proceduren e kerkuar nga ligji (sipas nenit 116 K.Pr.Administrative).

Nuk jemi ne keto kushte pasi raporti i kontrollit dhe akti nr.232/3 prot date 13.03.2014 jane njerre nga Drejtoria Rajonale Tatimore Lezhe, pra nje organ i identifikur.

Paditesi eshte subjekt i regjistruar prane Drejtorise Rajonale Tatimore Lezhe, dhe si i tille ne zbatim te nenit 69, kjo e fundit ka te drejte te nxjerre Njoftim Vleresim per detyrimet tatimore per paditesin. Ne mbeshtetje te nenit 68 te ligjit te procedurave tatimore, Drejtoria Rajonale Tatimore Lezhe ka nxjerre njoftim vleresim mbi rezultatet e kontrollit tatimor. Pra ne referim te ketyre dispozitave njoftim vleresimi objekt gjykimi eshte nxjerre per paditesin nga ana e Drejtorise Rajonale Tatimore Lezhe ne zbatim te kompetencave te saj ligjore.

Ne kreun X dhe ne nenit 80, e ne vijim eshte percaktuar se administrata tatimore kryen kontrole tatimore duke percaktuar edhe ate se cfare kontrollon, ne piken 3 ajo thote:

**3. Administrata tatimore kontrollon saktesine e te gjitha dokumenteve, qe kane te bejne me statusin ligjor, rezidencen, veprimtarine ekonomike, pagesat dhe detyrimet tatimore, si dhe cdo dokument tjeter me rendesi per percaktimin e detyrimit tatimor.**

Pra nga sa me siper tatimpaguesit nuk jane shkelur te drejtat e percaktuara me ligjin e mesiperm per ankim, tatimpaguesi e ka ushtruar te drejten themelore per ankimim. I pabazuar eshte pretendimi i paditesit per pavlefshmeri absolute te akteve administrative. Lidhur me kete pretendim kujtojme se pavlefshmeria absolute eshte nje rast ekstrem i pavlefshmerise qe ndodh kur akti eshte ne permbajtje e forme apo i nxjerre ne procedure ne kundershtrim flagrant me ligjin material dhe / ose procedural. Per pasoje kerkojme rrezimin e kerkese padise.

**Gjykata vlereson se;**

Ne baze te ligjit nr.9920 date 19.05.2008 "Per procedurat tatimore ne Republiken e Shqiperise" neni 80 pika 5 si dhe udhezimit te Ministrise se Financave nr.24 date 02.09.2008 "Per Procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperise", kreu X "Kontrolli Tatimor, pika 80.3 germa C. Verifikimet ne vend.

Kontrollet, qe kryhen nga administrata tatimore qendrore, urdherohen nga drejtori i Drejtorise Rajonale te tatimeve, duke u bazuar ne planet e kontrollit dhe rezultatet e analizës së riskut.

Keto verifikime te shkurtra synojne zbulimin ne kohe te shkeljeve qe kane lidhje me regjistrimin e personave te tatueshem (identifikimin e personave te paregjistruar), me perdorimin e pajisjeve fiskale, me perdorimin e pullave fiskale ne mallrat e akcizes, me dokumentimin e mallrave ne ruajtje, perdorim dhe transport, me dokumentimin e shitjeve dhe

leshimin faturave tatimore, etj. Keto verifikime kryhen pa njoftimin paraprak te personave te tatueshem, por vetem nepermjet prezantimit ne momentin e verifikimit, te dokumentit personal te verifikuesit dhe urdherin e dites, te leshuar nga drejtuesi i drejtorise se kontrollit per verifikime ne vend "Per procedurat tatimore ne Republiken e Shqiperise" i ndryshuar si dhe udhezimit nr.24 date 02.09.2008 "Per procedurat tatimore ne Republiken e Shqiperise" i ndryshuar, Neni 119 "Mosdeklarimi i punonjesve".

Nese nga verifikimi dhe kontrolli ne vendndodhjen e biznesit rezulton se tatimpaguesi nuk ka deklaruar ne organin tatimor cdo te punesuar rishtazi, te pakten nje dite kalendarike perpara fillimit te punes, pervec detyrimit per pagimin e shumes se detyrimeve tatimore dhe kontributeve te sigurimeve shoqerore e shendetesore, te llogaritura nga data e konstatimit, denohet me gjobe per cdo punonjes te padeklaruar si me poshte:

a) Tatimpaguesit e regjistruar si subjekte te tatimit mbi vleren e shtuar dhe tatimit mbi fitimin, me gjobe prej 500 000 (peseqind mije) lekesh;

**b) Tatimpaguesit e tjere, me gjobe prej 50 000 (pesedhjetë mije) lekesh.**

Drejtoria Rajonale Tatimore ka nxjerre njoftim vlesimin per detyrimet tatimore te njoftuara paditesit me Njoftim Vleresimin per Detyrimet nr. 15230/6 prot, date 30.12.2015 te Drejtorise Rajonale Tatimore Lezhe, subjekti i ka ankimuar ne Drejtorine e Apelimit Tatimor prane Drejtorise se Pergjithshme te Tatimeve Tirane ku kjo me vendimin nr.423/1, 2020/1 prot date 07.03.2016 ka vendosur lenien ne fuqi te aktit administrativ.

Paditesi duke mos qene dakort me aktin e siper cituar i drejtohet Gjykates me pretendimin se akti i tille eshte absolutisht i pavlefshem. Kodi i Procedurave Administrative do te quante akte absolutisht te pavlefshme ne rastet kur:

a) kur akti administrativ eshte njerre nga nje organ i administrativ i paidentifikuar.

b) kur akti administrativ eshte nxjerre nga nje organ administrativ ne kapercim te kompetencave te tij ligjore.

c) Kur akti administrativ eshte nxjerre ne kundërshtim me formen dhe proceduren e kerkuar nga ligji (sipas nenit 116 K.Pr.Administrative).

Raporti kontrollit dhe akti nr.232/3 prot date 13.03.2014, jane njerre nga Drejtoria Rajonale Tatimore Lezhe, pra nje organ i identifikuar.

Paditesi eshte subjekt i regjistruar prane Drejtorise Rajonale Tatimore Lezhe, dhe si i tille ne zbatim te nenit 69 kjo e fundit ka te drejte te nxjerre Njoftim Vleresim per detyrimet tatimore per paditesin. Ne mbështetje te nenit 68 te ligjit te procedurave tatimore, Drejtoria Rajonale Tatimore Lezhe ka nxjerre njoftim vleresim mbi rezultatet e kontrollit tatimor. Pra ne referim te ketyre dispozitave njoftim vleresimi objekt gjykimi eshte nxjerre per paditesin nga ana e Drejtorise Rajonale Tatimore Lezhe ne zbatim te kompetencave te saj ligjore.

Ne kreun X dhe ne nenit 80, e ne vijim eshte percaktuar se administrata tatimore kryen kontrole tatimore duke percaktuar edhe ate se cfare kontrollon, ne piken 3 ajo thote:

**3. Administrata tatimore kontrollon saktësinë e të gjitha dokumenteve, që kanë të bëjnë me statusin ligjor, rezidencën, veprimtarinë ekonomike, pagesat dhe detyrimet tatimore, si dhe cdo dokument tjetër me rëndësi për percaktimin e detyrimit tatimor.**

Pra nga sa me siper tatimpaguesit nuk jane shkelur te drejtat e percaktuara me ligjin e mesiperm per ankim, tatimpaguesi e ka ushtruar te drejten themelore per ankimim. I pabazuar eshte pretendimi i paditesit per pavlefshmeri absolute te akteve administrative. Lidhur me kete pretendim kujtojme se pavlefshmeria absolute eshte nje rast ekstrem i pavlefshmerise qe

mesiperm deri ne perfundimin e gjykimit te ceshtjes, prapsimet e palës së paditur që kërkon rrezimin e kërkesë padisë si të pa mbështetur në ligjë dhe në prova, shqyrtoi dhe analizoi çeshtjen ne teresi:

### **VEREN se;**

Paditesi Subjekti Fizik "Pashk Kalaja" i eshte drejtuar Gjykates Administrative Shkalle e Pare Shkoder me kerkese padi kunder anes se paditur Drejtoria Rajonale e Tatimeve Lezhe dhe Drejtoria e Pergjithshme e Tatimeve Tirane, me objekt; Konstatimin e pavlefshem te Njoftimit te vleresimit nr.15230/6 prot. date 30.12.2015 Drejtorise Rajonale Tatimore Lezhe dhe vendimit nr 423/1 prot. 2020/1 date 07.03.2016 te Drejtorise se Apelimit Tatimor Tirane si dhe pezullimin e zbatimit te vendimit te mesiperm deri ne perfundimin e gjykimit te ceshtjes.

### ***Rrethanat e ceshtjes:***

Nga ana e DRT-Lezhe me urdherin e punes nr 562 dt 28.09.2015 eshte ushtruar kontroll ne subjektin fizik "Pashke Kalaja" dhe, eshte mbajtur Akt-Konstatimi me nr serial 0540154 dt. 30.09.2015, ku ne permbajtje të tij thuhej: ne momentin ne pune u gjend Z,Pashke Kalaja dhe Kreshnik Kalaja me nr ID H6051108 UK, pas verifikimeve ka rezultuar qe punonjesi Kreshnik Prenga ishte i pa deklaruar ne organin tatimore .

Nga ana e paditur eshte mbajtur Njoftim Vleresim nr 15230/6 prot. date 30.12.2015 per detyrimet si me poshte :

*1-Vleresim Tatimor 50.000 leke per mosdeklarim te punesuarve ne organin tatimor.*

Kete vendim e ka ankimuar ne DRTP –Tirane dhe drejtoria e Apelimit Tatimor Tirane ne vendimin e saj ka refuzuar ankimin administrative te bere nga ana jone duke vendosur :

Lenien ne fuqi te aktit administrative,objekt ankimi,Njoftim Vleresimi per Detyrimet Tatimore nr. 15230/6 prot date 30.12.2015 te leshuar nga Drejtoria Rajonale Lezhe,detyrimin per gjobe ne shumen 50.000 leke per punemarres te padeklaruar dhe rrezimin e ankimit.

### ***Ne kërkesë padi paditësi parashton se :***

Duke ju referuar Akt-Konstatimit te mbajtur ne ambientet ku pretendohet se gjate kontrollit eshte gjetur nje punonjes i padeklaruar si i punesuar e kundërshtojmë atë pasi nuk eshte i bazuar ne ligj . Nga ana ime si Subjekt, punonjesit tatimore jane sqaruar se Kreshnik Prenga eshte punonjesi i Eurollotos, i Subjektit Tatimor "TOP START" te cilen ne e disponojme ne Lokal dhe rezulton i siguruar qe prej vitit 2009 .

Nga ana jone jane sqaruar punonjesit e Administrates Tatimore Lezhe se punonjesi eshte i siguruar.

Nga ana ime si Subjekt Fizik Tatimor kam bere deklarimin ne sistemin tatimor te punonjesit Kreshnik Kalaja pasi e kam punesuar edhe si punonjes me kohe te pjeshme si kamarier.

Ne zbatim te ligjit nr 9920 date 19.05.2008"Per Procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperise " nga ana ime si Subjekt e kam deklaruar punonjesin brenda dites qe ka filluar pune me date 30.09.2015.

Me vendimin nr 423/1 prot 2020/1 date 07.03.2016 te Drejtorise se Apelimit Tatimor Tirane te Drejtorise se Apelimit Tatimor prane Drejtorise se Pergjithshme te tatimeve Tirane jemi njohur ne si Operator Ekonomik ardhur me Poste.

Drejtoria e Apelimit Tatimor Tirane ne vendimin e saj ka refuzuar ankimin administrative te bere nga ana jone duke vendosur :Lenien ne fuqi te aktit administrative ,objekt ankimi ,Njoftim Vleresimi per Detyrimet Tatimore nr. 15230/6 prot date 30.12.2015 te leshuar nga

ndodh kur akti eshte ne permbajtje e forme apo i nxjerre ne procedure ne kundershkrim flagrant me ligjin material dhe / ose procedural.

Pavlefshmeria absolute sipas Kodit te Procedures Administrative dhe doktrines se te drejtes administrative eshte atehere dhe vetem atehere kur shkelja eshte kaq evidente, kaq e qarte, sa ajo s'ka as nevojë per ndonje shqyrtim te thelluar por mbi kete pavlefshmeri konkludohet me shikim te pare dhe gjykata vecse sa konstaton nje pavlefshmeri te tille. Jo cdo shkelje procedurale passjell pavlefshmerine absolute te akteve, ato duhet te jene te asaj natyre ne mungese te te cilave vendimmarrja e organit administrative do te kishte qene e ndryshme, qe ne ceshtjen ne shqyrtim nuk rezulton e tille.

Perfundimisht nga sa analizoi gjykata thekson se nuk mund te perdoren shkaqet e shfuqizimit per pavlefshmeri absolute e se nga analiza e nenit 116 te K.Pr.Administrative rezulton e qarte se ceshtja objekt gjykimi nuk eshte ne kushtet e nenit 116 te K.Pr. Administrative e per pasoje vendos rrezimin e kerkese padise si te pa mbeshtetur ne argumenta dhe ligj,prandaj

### **PER KETO ARSYE**

Gjykata, bazuar ne nenin 40, 41, 42 te ligjit nr 49/2012 "Per organizimin dhe funksionimin e Gjykatave Administrative dhe gjykimin e mosmarreveshjeve administrative" nenit 126, 306 dhe 310 të K.Pr.Civile

### **VENDOSI**

Rrëzimin e kërkesë padisë.

Shpenzimet gjyqsore sic janë bërë.

Ky vendim, përbën titull ekzekutiv dhe do të ekzekutohet menjëherë.

Ky vendim është i formës së prerë , ndaj të cilit nuk lejohet ankimi.

T'i komunikohet vendimi palëve ndërgjyqëse, paditësit subjektit fizik "Pashk Kalaja", palëve te paditura Drejtoria e Apelit Tatimor pranë Drejtorisë së Pergjithshme te Tatimeve Tirane, Drejtoria Rajonale Tatimore Lezhe dhe Avokatura e Shtetit Tiranë (në mungesë).

**Shkodër me datë 29.06.2016**

**SEKRETARE SEANCE**

**Borana LITI**



**GJYQTARE**

**Valbona DURRAJ**

